



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**FZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE**

Nr. 1961/2 Prot.

Tiranë, më 11.10.2022

V E N D I M

Nr. 21/1 datë. 11.10.2022

**PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË ZNJ. ENEIDA BARONI
NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NË DATËN 30.09.2021.**

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Z. Besnik Maho - Kryetar
Znj. Joana Asimi – Anëtar
Z. Julian Zonja - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Alma Zili
Znj. Eljona Bylykbashi
Znj. Jetmira Saraçi

Në mbledhjen e datës 10.10.2022, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit inspektor jomagjistrat

Znj. ENEIDA BARONI

OBJEKTI:

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së Znj. Eneida Baroni në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.

KOMITETI PASI :

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 30.09.2021, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 9 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 29.10.2021, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 08.11.2021, ku vendosi për radhën e shqyrtimit të dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave/zhvillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të

kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”.

4. Në zbatim të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimeve dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pasi zhvilloi procedurat e verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore për pozicionin e inspektorit, në mbledhjen e datës 07.07.2022, vendosi lejimin e kandidimit për pozicionin e inspektorit jomagjistrat për znj. Eneida Baroni dhe me komunikimin e datës 14.09.2022, njoftoi kandidatët për fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve.
5. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve me vendimin nr.21, datë 07.07.2022 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Eneida Baroni për Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 209 e vijues të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësisë të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, hartoi relacionin e vlerësimit të këtij kandidati.
6. Sipas kalendarit të intervistave të miratuar, në 21.09.2022 dhe 22.09.2022, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit, për 9 (nëntë) vendet vakante.
7. Intervista mbi motivimin e kandidimit, znj. Eneida Baroni, kandidati për të 9 (nëntë) vendet vakante në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, u zhvillua në datën 21.09.2022.

II. Vlerësimi i Komitetit

8. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidatit, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Komitetit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Komiteti ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit Eneida Baroni për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara në shpjegimet e hollësishme të metodologjisë mbi të cilën bazohet vlerësimi dhe pikëzimi, miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përkatësisht:

1. Meritat profesionale - (50) pikë

A. Historiku Arsimor dhe Profesional - (10) pikë

9. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Eneida Baroni, disponon këto të dhëna:
- Arshivist Operator, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për periudhën 06 Mars 2006-18 Maj 2006;
 - Specialist i Zyrës me Jashtë dhe Shtypin, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për periudhën 19 Maj 2006 -13 Nëntor 2007;
 - Shërbimi me klientin, First Investment Bank, Albania për periudhën 21 Prill 2008-5 Mars 2010;
 - Specialist, Këshilli i Lartë i Drejtësisë për periudhën 08 Mars 2010-01 Prill 2013;
 - Përgjegjës Sektori, Këshilli i Lartë i Drejtësisë për periudhën 01 Prill 2013-26 Korrik 2013;
 - Specialist (Jurist), CEZ Shpërndarje për periudhën 20 Nëntor 2013 - 23 Korrik 2014;
 - Specialist (Jurist) OSHEE, Tiranë për periudhën 23 Korrik 2014 - 01 Gusht 2015;
 - Shef Sektori, OSHEE, Tiranë për periudhën 01 Gusht 2015 - 04 Shtator 2017;
 - Specialist (Jurist) OSHEE, Tiranë për periudhën 04 Shtator 2017 - 31 Maj 2018;
 - Shef Sektori, OSHEE, Tiranë për periudhën 01 Qershor 2018 - 02 Maj 2019;
 - Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për periudhën 1 Maj 2019 - 08 Maj 2020;
 - Supervizor i Auditit të Brendshëm, Bankers Petrolum Albania për periudhën 11 Maj 2020-16 Shtator 2020;
 - Avokat, Bankers Petrolum Albania për periudhën 16 Shtator 2020- deri në datën e paraqitjes së aplikimit.

a) Historiku Arsimor - (2) pikë

10. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së **arsimit të lartë juridik** me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlershëm me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

11. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Eneida Baroni ;

- Ka përfunduar Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës në periudhën 2004, duke u diplomuar “*Jurist*”. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës , rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare 7.9

12. Prandaj, Komiteti vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlershëm me të, secilin kandidat sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.

13. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare 7.9 , e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Komitetit çmoi ta vlerësojë kandidatin **Eneida Baroni** me **0 (zero) pikë.**

b. Kualifikime Pasuniversitare - (5) pikë

b.1 Studimet pasuniversitare - (1/5) pikë

14. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

15. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor jomagjistrat.
16. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, nuk rezulton që kandidati znj. Eneida Baroni të këtë ndjekur studime pasuniversitare brenda ose jashtë vendit (MND, Master profesional/Ekzekutiv, programet e studimeve të formimit të vazhduar etj, të barzvefshëm me to, në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”).
17. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me studimet pasuniversitare, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin znj. Eneida Baroni me **0 (zero) pikë.**

b.2 Gradat shkencore - (3/5) pikë

18. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.
19. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor jomagjistrat.
20. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, nuk rezulton që kandidati Eneida Baroni të këtë fituar brenda ose jashtë vendit grada shkencore në bazë të të nenit 60,61 dhe 79 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, (Dr, Phd, Prof apo Pro/asoc, Magjistraturë, etj).

21. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me gradat dhe kërkimin shkencor, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin znj. Eneida Baroni me **0 (zero) pikë.**

b.3 Lista dhe lloji i trajnimeve - (1/5) pikë

22. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Eneida Baroni ka ndjekur disa veprimtari trajnimi afatshkurtra të dokumentuara, konkretisht:

- **Periudha: Maj 2019**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnimi Rajonal i Evropës Qendrore dhe Lindore mbi Kriteret e Dhunës me Bazë Gjinore në Traktatin e Tregtisë së Armëve

- **Periudha: Tetor 2018**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Praktikat më të mira në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. Pajisur me certifikatë për periudhën 4-6.10.2018 nga BEUC (Organizata Europiane e Konsumatorit)

- **Periudha: Tetor 2012**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Hartimi i Shkresave Zyrtare dhe Komunikimi. Pajisur me certifikatë nr. GTAP07-04-2012/24, datë 5.11.2012 nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike

- **Periudha: Shkurt 2010**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Trajnim për komunikim efektiv me klientët dhe shërbimet e shitjes. Standardet dhe rregullat për të punuar me klientin. Pajisur me certifikatë. Pajisur me certifikatë.

- **Periudha: Qershor 2006**

Tematika dhe fusha e trajnimit të fituar: Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun.: Pajisur me certifikatë nga UNDP Albania.

23. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me trajnimet, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin znj. Eneida Baroni me **1 (një) pikë.**

c. Njohja e gjuhëve të huaja - (3) pikë

24. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se njeh shumë mire gjuhën Angleze, Italiane dhe njeh mire atë Spanjolle.
25. Në dosje ndodhet dëshmia e datës 28.02.2006 e lëshuar nga, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, ku është vlerësuar me notën 6 (gjashtë). Gjithashtu ndodhet një dëshmi e lëshuar nga po i njëjti institucion e cila vërteton mbrojtjen e gjuhës italiane me notën 7 (shtatë)

dhe një certifikatë e lëshuar nga Qendra Jupiter si dokument i zotërimit të gjuhës së huaj spanjolle.

26. Për këto arsye, duke pasur parasysh dokumentacionin e administruar, Komiteti çmoi se për shkallën e zotërimit të gjuhëve të huaja, veçanërisht atë anglisht, e cila është dhe e dokumentuar me dokument vlerësues për nivelin e zotërimit të saj me notën gjashtë, si dhe duke mbajtur parasysh zotërimin e gjuhëve të tjera të deklaruara të shoqëruar edhe me dokumentet përkatëse vlerësuese për nivelin e njohurive të tyre, çmoi ta vlerësojë kandidatin Eneida Baroni për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **2 (dy) pikë**.

B. Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional - (30) pikë

27. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe kualifikimi **i përgjithshëm profesional**, përcaktohen si kriter vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.
28. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale **prej 30 pikësh** sipas urdhrit nr. 7 referuar si më sipër, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të **një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin** dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor jomagjistrat.
29. Në rastin e kandidatit Eneida Baroni, Komiteti shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e tij profesionale ndër vite, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të këtij kandidati në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

a. Vlerësimi sasior - (5) pikë

30. Për sa i përket **vlerësimit sasior**, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, rezulton se në dosjen e kandidimit është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm që ka të bëjë me aktivitetin profesional, kërkimin shkencor dhe publikimet nga ana e kandidatit znj. Eneida Baroni:

- Model deklaratë mbrojtje, datë ___/___/2020, drejtuar Gjykatës të Rrethit Gjyqësor....., konceptuar nga kandidati, sipas nënshkrimit të këtij dokumenti të depozituar në ILD (15 faqe);
- Model kthim përgjigje kërkesës tuaj të datës ___/___/2020, drejtuar Z/Znj.....në lidhje me një proces gjyqësor civil që po zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.....,ku ai/ajo është në pozitat e palës paditëse më gjyqtare znj....., konceptuar nga kandidati, sipas anëshkrimit të këtij dokumenti të depozituar në ILD (2 faqe);
- Model tërheqje vëmendje ku Inspektori i ish KLD-së i tërheq vëmendjen në bazë të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, znj....., gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor....., për zvarritje të gjykimit, konceptuar nga kandidati, sipas nënshkrimit të këtij dokumenti të depozituar në ILD (2 faqe);
- Model akt bazë për ruajtjen e konfidencialitetit, ku shtetasi XXXX në pozicionin e _____ në Departamentin e _____, pranon kushtet e aktit të konfidencialiteti në marrëdhëniet e punës, konceptuar nga kandidati, sipas nënshkrimit të këtij dokumenti të depozituar në ILD (3 faqe);
- Model- memo, datë XXX.XXX.2020, drejtuar Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të eksporteve në lidhje me inspektimin e zhvilluar mbi zbatimin detyrimeve që burojnë nga VKM nr. 675, datë 28.092016 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil”, konceptuar nga kandidati, sipas nënshkrimit të këtij dokumenti të depozituar në ILD (2 faqe);
- Model rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, nga strukturat e Bankers Petroleum Albania LTD, konceptuar nga kandidati, sipas nënshkrimit të këtij dokumenti të depozituar në ILD dhe (17 faqe) ;

31. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Komiteti vlerëson se në aspektin sasior kandidati Eneida Baroni ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë dukshëm përtej asaj që mund të gjykohet si një angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin znj. Eneida Baroni për këtë kriter ligjor vlerësimi me **4 (katër) pikë.**

a. Vlerësim cilësor - (25) pikë

32. Për sa i përket **vlerësimit cilësor**, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Komitet dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit jomagjistrat.
33. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidati Eneida Baroni, për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, ka paraqitur pesë dokumentet profesionale si më poshtë:
- Model deklaratë mbrojtje, datë ___/___/2020, drejtuar Gjykatës të Rrethit Gjyqësor....., konceptuar nga kandidati, (15 faqe). Në këtë akt procedural Model deklaratë mbrojtje në emër të palës të paditur Shoqëria.....Shpk, strukturohen dhe analizohen në formën e argumenteve ligjore, të gjitha shkaqet, sepse kërkesë-padia e paraqitur nga Shoqëria.....Shpk, me Objekt shpërbllim dëmi, nuk është e bazuar në ligj dhe në prova dhe duhet të rrëzohet nga ana e Gjykatës.
 - Model kthim përgjigje kërkesës tuaj të datës ___/___/2020, drejtuar Z/Znj.....në lidhje me një proces gjyqësor civil që po zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor....., ku ai/ajo është në pozitë e palës paditëse më gjyqtare znj....., (2 faqe). Në këtë Model-akt, kthim përgjigje, jepen të gjitha arsyet ligjore në bazë të nenit 5, 6 dhe 27 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, sepse nuk mund të miratohet kërkesa e depozituar nga një subjekt konkret, për dhënie informacioni në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në lidhje me një proces gjyqësor civil që po zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, ku ai/ajo është në pozitë e palës paditëse;
 - Model tërheqje vëmendje ku Inspektorati i ish KLD-së, në bazë të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, znj....., gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor (2 faqe). Në bazë të këtij Model-akti me titullin “tërheqje vëmendje”, tregohet baza ligjore sikurse është ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, jepen konstatimet e Inspektoratit të ish KLD mbi zvarritjet e pajustificuara të seancave gjyqësore dhe te organizimit të punës së gjyqtarit për gjykimin sa më të shpejtë të çështjes.
 - Model- memo, datë XXX.XXX.2020, drejtuar Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të

eksporteve, në lidhje me inspektimin e zhvilluar mbi zbatimin detyrimeve që burojnë nga VKM nr. 675, datë 28.092016 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil”, (2 faqe). Në këtë Model- memo, kandidati znj. Eneida Baroni në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë të Analizës dhe Vlerësimit i drejtohet Kryetarit të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, ku i parashtron në formën e një informacioni të përmbledhur se çfarë qëllimi pati kryerja e inspektimit të zhvilluar mbi zbatimin detyrimeve që burojnë nga VKM nr. 675, datë 28.092016 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse për përdorim civil si dhe rekomandimet përkatëse bazuar në gjetjet e inspektimit të realizuar”.

- Model rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, nga strukturat e Bankers Petroleum Albania LTD dhe Model Akt-Bazë për ruajtjen e konfidencialitetit, ku shtetasi XXXX në pozicionin e _____ në Departamentin e _____, pranon kushtet e aktit të konfidencialiteti në marrëdhëniet e punës, (20 faqe).
 - Model rregullorja, përmban rregullat mbi përcaktimin e procedurave organizative e teknike, masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të tyre, mbështetur në legjislacionin vendas, aktet nënligjore të Komisionerit për Përpunimin e të Dhënave Personale dhe aktet ndërkombëtare, ndërkohë Model Akt-Bazë është një akt i brendshme me karakter rregullator për ruajtjen e konfidencialitetit, nga ana e punonjëseve lidhur me detyrat që ata do përmbushin gjatë marrëdhënieve të punës.
34. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati **Eneida Baroni** dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë orientime që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor.(shtojca nr.2).
35. Dokumentet trajtojnë tematika në fushën e së drejtës në të cilën ka operuar ndër vite kandidati, përfshi ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ligjshmërisë së veprimtarisë administrative të organeve shtetërore dhe personave juridikë, mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit në përmbushjen e detyrimeve të organit shtetëror si edhe të subjekteve dhe individëve në raport me të drejtat dhe detyrimet përkundrejt administratës publike, hartimit të akteve nënligjore të brendshme për llogari të një subjekti juridik privat. Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati znj. Eneida Baroni, për sa më sipër, si dhe intervista e zhvilluar me të nga ana e Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, vlerësimi i dokumenteve profesionale bëhet në pesë komponentë kryesorë që janë, origjinaliteti dhe/ose impakti i veprimtarisë profesionale të kandidatit, aftësitë analitike, aftësitë kërkimore, saktësia dhe precizioni, si dhe qartësia.

36. Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe Platforma e paraqitur nga vetë kandidati znj. Eneida Baroni, për sa më sipër si dhe intervista e zhvilluara me të nga ana e Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, vlerësimi i këtyre të dhënave bëhet në pesë komponentë kryesorë që janë, origjinaliteti dhe/ose impakti i veprimtarisë profesionale të kandidatit, aftësitë analitike, aftësitë kërkimore, saktësia dhe precizoni, si dhe qartësia.

b/1. Origjinalitet dhe/ose impakti (6) pikë

37. Njëri nga indikatorët vlerësues të dokumenteve profesional është **“Origjinaliteti dhe/ose impakti”**. Nisur nga profili profesional i kandidatit Eneida Baroni, përmbajtja e dokumenteve të analizuara dhe dobisë së tyre nga profesionistë të fushës apo grupeve të interesit, Komiteti vëren se dokumentacioni i paraqitur ofron një panoramë të elementëve të një qasje profesionale origjinale në trajtimin e çështjeve ligjore para Gjykatës, në drejtim të profesionistëve të drejtësisë dhe të individëve. Për rrjedhojë krahas disa elementëve të origjinalitetit në përmbushjen e detyrës për aq sa e lejon natyra e saj, duke sjellë argumente në dobi të punës në praktikën gjyqësore, si dhe mirëfunksionimin subjekteve juridikë privatë dhe të administratës publike.

38. Për rrjedhojë pas shqyrtimit të dokumentacionit, në zërin **“Origjinaliteti dhe impakti”**, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

b/2. Aftësitë analitike - (6) pikë

39. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me **“Aftësitë analitike”**, Komiteti duke u përqendruar në aktet e paraqitura arrin në konkluzionin se parashtrimet e bëra nga kandidati Eneida Baroni tregojnë dhe dëshmojnë zotërimin e aftësisë profesionale të kandidatit për të arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore në fushën e përkatëse, mundësisë për të mbledhur dhe analizuar informacione, për të identifikuar çështjet ligjore dhe për të ofruar argumente në lidhje me zbatimin e parashikimeve ligjore për zgjidhjen e tyre.

40. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit të analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me zërin **“Aftësitë analitike”**, Komiteti vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

b/3. Aftësitë kërkimore - (4) pikë

41. Në lidhje me treguesin **“Aftësitë kërkimore”**, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin profesional të paraqitur nga kandidati, duke vërejtur se përdoren në një masë të ulët burimet nga sistemi ligjore vendas apo i huaj ose të identifikojë praktikë gjyqësore në mbështetje të argumenteve të caktuara, si dhe pati vështirësi për të dalluar aftësinë për të kërkuar, shkëputur dhe përdorur informacionet të cilat janë relevante për temën e caktuar.

42. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “Aftësitë kërkimore”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 (dy) pikë**.

b/4. Saktësia dhe precizioni - (5) pikë

43. Referuar kriterit “**Saktësia dhe precizioni**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur duke shmangur përsëritjet në material. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të mjaftueshëm të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike, duke shmangur detajet e panevojshme dhe duke përdorur në mënyrë korrekte termat ligjore.
44. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Saktësia dhe precizioni**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

b/5. Qartësia - (4) pikë

45. Referuar kriterit “**Qartësia**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët e kanë strukturuar tematikën dhe problemin duke qartësuar gjuhën dhe duke përdorur në mënyrë të kënaqshme terminologjinë profesionale. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të kuptueshëm të parashtrimeve.
46. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Qartësia**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 (dy) pikë**.
47. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, që përbëjnë **vlerësimin cilësor** të kandidatit, Komiteti vendosi të vlerësojë kandidatin me **13 (trembëdhjetë) pikë**.

C. Kualifikim shtesë profesional - (10) pikë

a. Përvoja dhe cilësia profesionale e posaçme për rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së - (7) pikë

48. Rezultatet profesionale në lidhje me këtë kriter vlerësimi, shqyrtohen nga Komiteti për të vlerësuar veçanërisht rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojat e veçanta profesionale të kandidatit të cilat tregojnë vlera të spikatura profesionale në shërbim të drejtimit, organizimit dhe funksionimit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe të ushtrimit të kompetencave të këtij institucioni, përfshirë këtu vlerësimin

e njohurive të posaçme profesionale në lidhje me ushtrimin e kompetencave të kontrollit. Inspektiveve, hetimeve disiplinore si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji.

49. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 10 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Komiteti, vlerëson deri në 7 pikë ekspertizën në fushat e së drejtës dhe posaçërisht në çështjet e drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe ushtrimit të kompetencave me natyrë kontrolli, inspektimi, hetimi disiplinor si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Gjithashtu, Komiteti vlerëson deri në 3 (tre) pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve të cilat nuk janë vlerësuar nga inspektori sipas kriterëve të mëparshme, pra, as në kriterin “Kualifikim i Përgjithshëm Profesional” dhe as në kriterin “Përvoja dhe cilësi profesionale të posaçme për rolin dhe funksionet e Inspektorit pranë ILD-së”. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara në urdhrin nr. 7 (si më sipër) të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve .
50. Veprimtaria profesionale që kandidati znj. Eneida Baroni, ka ushtruar si Arshivist Operator/specialiste, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si specialiste pranë Shërbimit me Klientin, First Investment Bank, Albania, si Specialiste pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si Përgjegjës Sektori, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si Specialist (Jurist), CEZ Shpërndarje dhe Shef Sektori, pranë OSHEE, Tiranë, si Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit, pranë Autoriteti të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, si Supervisor i Auditit të Brendshëm/Përfaqësues ligjor, pranë Bankers Petroleum Albania është një veprimtari që ka lidhje, me një pjesë të konsiderueshme të veprimtarisë funksionale dhe detyrimeve ligjore që përmbush Inspektori i Lartë të Drejtësisë.
51. Model deklaratë mbrojtje, model akt bazë për ruajtjen e konfidencialitetit, model- memo dhe model rregullor, etj, janë një pjesë e akteve me karakter administrativ dhe nënligjor, që kandidati ka përmbushur, gjatë kohë që ka shërbyer pranë institucioneve të mëparshme/aktual punëdhënës (*ente publikë/privatë*).
52. Lidhur me këtë kriter, Komiteti pasi shqyrtoi dokumentet profesionale të depozituara në dosjen e kandidimit dhe të analizuar më sipër lidhur me rëndësinë që ato mbartin, të dhënat e jetëshkrimit, si dhe intervistën e zhvilluar dhe motivimin për kandidim, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për kriterin e “Përvojës dhe cilësisë profesionale që a ka ushtruar në raport me rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së”, e vlerëson kandidatin znj. Eneida Baroni me **4 (katër) pikë.**

b. Angazhime profesionale shtesë. - (3) pikë

53. Nga aktet e dosjes dhe nga vetëdeklarimet e kandidatit Eneida Baroni, rezulton se ka paraqitur angazhime shtesë profesionale, sikurse është zotërimi i licencës të ushtrimit të profesionit të avokatit në sektorin privat.

Periudha: 2010

Lloji i titullit/ fusha profesionale : Avokat me nr. 4358 Licence;

Emri dhe lloji i institucionit që ka dhënë titullin : Dhoma Kombëtare e Avokatëve të Shqipërisë

54. Duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trajnuese të ndjekura nga kandidati Eneida Baroni, për këtë kriter ligjor vlerësimi Komiteti çmoi ta vlerësojë me **1 (një) pikë.**

55. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë merita profesionale dhe kualifikim shtesë profesional, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **5 (pesë) pikë.**

2. MERITA MORALE, ORGANIZATIVE, DREJTUESE DHE MENAXHERIALE - (50) pikë

2/1. Merita morale - (25) pikë

56. Si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për integritet të lartë moral dhe profesional. Konkretisht përcaktohen si kriterë vlerësimi edhe "Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve" dhe "cilësi morale të tilla si: Ndershmëria, përpikëria, drejtësia në marrjen e vendimeve dhe ushtrimin e detyrave" si edhe "angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile".

57. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Komiteti vlerëson deri në 15 pikë integritetin etik dhe moral, deri në 8 pikë reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve dhe deri në 2 pikë angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

58. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Komitetin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës. Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të këtij kandidati.

a. Integriteti etik e moral - (15) pikë

59. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, integritetit etik e moral, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon përkushtim dhe angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje, ndjeshmëri dhe respekt në komunikim e bisedë, duke parashtruar argumentet e tij me kompetencë, dinjitet, duke dëgjuar dhe përgjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërmbytje përkundrejt qëndrimeve dhe pyetjeve të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.
60. Nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Komitetit nuk i rezulton që kandidati të ushtrojë apo të ketë ushtruar funksionet e tij profesionale duke favorizuar palë të caktuara apo duke kërkuar përfitime për veten apo për të tjerët. Nuk rezultojnë të dhëna që ky kandidat të mos ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, të ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me koleget, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune etj. Pra nuk ka të dhëna që me sjelljen dhe veprimtarinë e tij në jetën profesionale dhe personale të ketë cenuar apo të rrezikojë të cenojë imazhin dhe figurën publike të nëpunësit shtetëror dhe sistemit të drejtësisë. Referuar letër rekomandimeve të dhëna nga Kryeinspektor znj. Marsida Xhaferllari, kandidati Eneida Baroni vlerësohet si një punonjës në të cilën dominon respekti për norma, ligjet, vlerat etike, si dhe nga letër rekomandimi i lëshuar nga znj. Etleva Agolli, Drejtor i Drejtorisë Juridike OSHEE, si epror i saj ajo vlerësohet si profesioniste, e motivuar dhe korrekte. Referuar letër rekomandimit të z. Engjëllush Bekteshi, Kryetar i Autoritetit Shtetëror të Kontrollit të Eksporteve/Ministria e Mbrojtjes, kandidati vlerësohet me etikë në punë dhe vëmendje ndaj detajeve.
61. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "integritetit etik e moral", Komiteti e vlerëson kandidatin me **15 (pesëmbëdhjetë) pikë**.

b. Reputacioni në shoqëri dhe midis kolegëve - (8) pikë

62. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve", nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim. Intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati me veprimtarinë dhe sjelljen në shoqëri, tregon angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave për zbatimin e drejtë të ligjit në ushtrimin e kompetencave që i ngarkon ligji.

63. Në lidhje me vlerësimin e punës dhe reputacionin që kandidati znj. Eneida Baroni gëzon, rezulton se pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kandidati ka dorëzuar Rekomandim nga Autoriteti Shtetëror i Kontrollit të Eksporteve Ministria e Mbrojtjes, Maj-2020, Rekomandim datë 17.11.2016 të lëshuar znj. Marsida Xhaferllari si Kryeinspektor i Inspektoratit të KLD-së si dhe Rekomandim të lëshuar nga znj. Etleva Agolli, Drejtor i Drejtorisë Ligjore në OSHE, që venë në dukje cilësitë e saja etiko-profesionale.
64. Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarinë e tij përmbush të gjitha pritshmëritë e aspektit moral për marrjen e përgjegjësiive ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmërinë e publikut për gëzimin e cilësive profesionale e morale për ushtrimin e detyrës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me kriterin vlerësues “të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **7 (shtatë) pikë.**

c. Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile - (2) pikë

65. Për sa i përket kriterit të vlerësimit që lidhet me angazhimin në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se, përgjithësisht, kandidati nuk ka qenë i angazhuar në veprimtari të tjera të përshtatshme jashtë atyre të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.
66. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “**Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **0 (zero) pikë.**
67. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave morale, rezulton se kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **22(njëzetedy) pikë.**

2/2. Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale - (25) pikë

68. Ky komponent zërthehet në disa nën komponentë të tjerë, konkretisht:

- a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- c) aftësitë e komunikimit;
- d) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- dh) aftësitë e përfaqësimit publik.

69. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” ku përcaktohen rregullime me të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kritereve.
70. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 25 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Komiteti vlerëson deri në 8 pikë cilësinë e platformës dhe vizionin që paraqesin kandidatët, deri në 10 pikë aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore, deri në 5 pikë aftësisë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik, si edhe me 2 pikë për aftësitë e të punuarit në grup dhe ambiente multidisiplinore.
71. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” dhe Shtojcën nr. 2 të tij si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituarra sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor.
72. Komiteti shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës dhe arsyt apo motivet e kandidimit dhe vizionit të kandidatit lidhur me qasjen dhe qëndrimet e tij mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së Inspektorit, mbi sfidat kryesore me të cilat duhet të përballet Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e përgjegjësi dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji, si edhe lidhur me mendimet e kandidatit për çështjet që duhet të trajtohen me përparësi e në perspektivë për mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e këtij institucioni të ri dhe shumë të rëndësishëm kushtetues, për ushtrimin efektiv dhe me nivel të lartë profesional e besueshmërie të kompetencave të tij në funksion të ndërtimit të një sistemi drejtësie të bazuar në integritetin profesional e moral, nisur edhe nga pritshmëritë e jashtëzakonshme të publikut pas miratimit dhe vënies në zbatim të reformës në drejtësi. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Komiteti mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga ky kandidat gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Komitetit.

a. Cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqet kandidati - (8) pikë

73. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Komiteti vëren se kandidati paraqiti një nivel mesatar të njohjes dhe përvojës profesionale së saj në lidhje me

rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të inspektorit jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe elemente premtues që tregojnë cilësi, thellësi dhe origjinalitet për sa i përket sfidave me të cilat do të përballet kandidati, objektivat për çështjet e organizimit dhe funksionimit cilësor dhe efektiv të institucionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke vënë theksin të pavarësia e tij, respektimi i procesit të rregullt ligjor, zhvillimi i marrëdhënieve me publikun, sjellja e sistemit të drejtësisë në parametrat dhe cilësinë e performancës së ngjashme me vendet e BE, unifikimin e praktikave të inspektimit e respektimit të standardeve evropiane të kontrollit.

74. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "Cilësia e platformës dhe vizionit të paraqitur" nga kandidatet, Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë.**

b. Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale shoqërore - (10) pikë

75. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Komiteti mbështetet pikësepari në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësi dhe ushtrimin e vendimmarrjes në përbushjen e kompetencave dhe të detyrave të ngarkuara, veçanërisht për aspektet e drejtimit dhe të administrimit të punëve. Në këtë drejtim, Komiteti shqyrton dhe vlerëson posaçërisht aftësitë e provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësi si edhe për të marrë vendimet e duhura në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.

76. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në interviste, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit. Për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Komiteti për vlerësimin e këtij kriteri i referohet edhe rolit drejtues të kandidatit në pozicionin që ka mbajtur si përgjegjës i sektorit të marrëdhënieve me gjyqësorin në OSHEE, drejtorit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Vlerësimit të Riskut në Autoritetin Shtetëror të Kontrollit të Eksporteve/Ministria e Mbrojtjes, shefes së sektorit juridik në KLD, me funksione të dhënies së mendimit për hartimin e akteve nënligjore të funksionimit të brendshëm, për të menaxhuar burimet njerëzore, si dhe referuar letër rekomandimeve është e aftë të zgjidhë situata konfliktuale dhe problematike midis stafit dhe me të tretë.

77. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **5 (pesë) pikë.**

c. Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik - (5) pikë

78. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me nëpunësit dhe punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me organet e tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe përfaqësuesit e tyre, me gjyqtarët dhe prokurorët, sikurse edhe në komunikimin dhe përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jo diskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

79. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësi të mjaftueshme për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për t’u përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, me stil dhe gjuhë të pasur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.

80. Gjithashtu referuar prezantimit të bërë gjatë intervistës, rezulton se ky kandidat zotëron edhe aftësi të mira për përfaqësimin publik, prezanton thjeshtësi, aftësi për të shprehur bindjet e tij me vetëbesim. Kandidati transmeton besueshmëri gjatë komunikimit dhe aftësi për t’u përgjigjur me etikë. Në referim të letër rekomandimeve, kandidati vlerësohet me aftësi shumë të mira komunikuese, duke u dalluar për marrëdhënie shumë të mira me kolegët dhe bashkëpunëtorët.

81. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik", Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë.**

d. Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale - (2) pikë

82. Inspektori për vetë natyrën e këtij institucioni dhe funksioni, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të organizuar dhe për të qenë i përfshirë në punën në grup, me nëpunësit dhe punonjës të Zyrës dhe për aq sa kërkohet dhe nevojitet me funksionarë e përfaqësues të institucioneve të tjera dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për tu përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj

nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

83. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup, përfshirë atë për të punuar në ambiente multikulturore dhe multidisiplinore. Referuar letër rekomandimeve për kandidatin Eneida Baroni, ajo vlerësohet se është e organizuar, e besueshme dhe e gatshme për të punuar në grup, duke nxjerrë me të mirën e grupit.
84. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore", Komiteti vlerëson t'i caktojë kandidatit **2 (dy) pikë**.
85. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **15 (pesëmbëdhjetë) pikë**.

III - Vlerësimi përfundimtar i kandidatit

86. Në përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar me sipër në këtë vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së Inspektorit jomagjistrat dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për këtë vend vakant, Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i rezulton se kandidati Eneida Baroni vlerësohet në total me **63 (gjashtëdhjetetë) pikë**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidatit Eneida Baroni, me **63 (gjashtëdhjetetë) pikë**, në lidhje me kandidimin e tij për vendin vakant inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Eneida Baroni.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR


Julian Zonja

KRYETAR


Besnik Maho

ANËTAR


Joana Asimi

